



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Parashtrimeve dhe Rishikimin e
Transkripteve të Seancave Private gjatë Periudhës së Pushimit Dimëror të
Gjykatës**

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Luka Mishetiç

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagendra

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykses"), në bazë të neneve 21 and 40(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9 dhe 77(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 5 dhjetor 2024, Mbrojtja e Kadri Veselit ("Mbrojtja e Veselit") kërkoi gojarisht pezullimin e afatit për dorëzimin e parashtrimeve nga 16 dhjetori 2024 deri në 13 janar 2025 ("Kërkesa").¹
2. Të njëjtën ditë, Trupi Gjykses dëgjoi parashtrimet e palëve për Kërkesën² dhe i inkurajoi të kryejnë diskutime të mëtejshme lidhur me listën e parashtrimeve që do të dorëzohen para pushimit dimëror të Gjykatës.³
3. Më 11 dhjetor 2024, Trupi Gjykses urdhëroi palët ta informojnë për rezultatin e diskutimeve *inter partes* lidhur me Kërkesën deri më 13 dhjetor 2024.⁴
4. Më 12 dhjetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") informoi Trupin Gjykses për rezultatin e diskutimeve *inter partes* lidhur me Kërkesën dhe paraqiti listën e parashtrimeve që do të dorëzohen para pushimit dimëror.⁵
5. Ndërmjet 12 dhe 17 dhjetorit 2024, Mbrojtja e z. Thaçi ("Mbrojtja e Thaçit"),⁶ Mbrojtja e z. Selimi ("Mbrojtja e Selimit")⁷ dhe Mbrojtja e z. Krasniqi ("Mbrojtja e

¹ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, konfidencial, f. 23530, rreshti 25 deri në f. 23531, rreshti 2.

² Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, konfidencial, f. 23532, rreshti 3 deri në f. 23533, rreshti 6.

³ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, konfidencial, f. 23533, rreshtat 7-25.

⁴ CRSPD690, Mesazh Elektronik nga Trupi Gjykses drejtuar Palëve dhe Pjesëmarrësve lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 11 dhjetor 2024, konfidencial.

⁵ CRSPD690, Mesazh Elektronik nga ZPS-ja drejtuar Trupit Gjykses lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 12 dhjetor 2024, konfidencial.

⁶ CRSPD690, Mesazh Elektronik nga Mbrojtja e Thaçit drejtuar Trupit Gjykses lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 12 dhjetor 2024, konfidencial.

⁷ CRSPD690, Mesazh Elektronik nga Mbrojtja e Selimit drejtuar Trupit Gjykses lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 16 dhjetor 2024, konfidencial.

Krasniqit”),⁸ njoftuan Trupin Gjykses se kishin rënë dakord për pezullimin e të gjitha afateve të parashtrimeve, me përjashtim të atyre që lidhen me rishikimin e paraburgimit.

II. PARASHTRIMET

6. Mbrojtja e Veselit kërkoi pezullimin e afateve të parashtrimeve nga 16 dhjetori 2024 deri më 13 janar 2025, me përjashtim të rishikimit të paraburgimit dhe parashtrimeve urgjente.⁹ Mbrojtja e Selimit bëri me dije zyrtarisht se nuk e kundërshtonte kërkesën.¹⁰ Dy ekipet e tjera të Mbrojtjes nuk e kundërshtuan kërkesën.

7. ZPS-ja u përgjigj se zakonisht është e hapur për këto kërkesa, por se varet nga parashtrimet konkrete dhe sugjeroi diskutime *inter partes*, rezultati i të cilave do t'i njoftohet Trupit Gjykses.¹¹

8. Pas diskutimeve *inter partes*, palët dhe pjesëmarrësit ranë dakord, në varësi të miratimit të Trupit Gjykses, për pezullimin e afateve të parashtrimeve gjatë periudhës së pushimit dimëror të Gjykatës, përfshirë ato për rishikimin e transkripteve të seancave private, me përjashtim të parashtrimeve lidhur me rishikimin e paraburgimit.¹² Gjithashtu, palët ranë dakord që, në qoftë se pala ose pjesëmarrësi parashtrues gjykon se një parashtrim, që nuk është për rishikimin e paraburgimit, kërkon vëmendje të menjëhershme, pala ose pjesëmarrësi parashtrues e evidenton urgjencën në kërkesë, bashkë me arsyetimin përkatës.¹³

⁸ CRSPD690, Mesazh Elektronik nga Mbrojtja e Krasniqit drejtuar Trupit Gjykses lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 17 dhjetor 2024, konfidencial.

⁹ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, konfidencial, f. 23530, rreshti 25 deri në f. 23531, rreshti 2 dhe f. 23532 rreshtat 11-12 dhe 15-17.

¹⁰ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, konfidencial, f. 23532, rreshti 20 deri në f. 23533, rreshti 6.

¹¹ Transkripti i seancës, 5 dhjetor 2024, konfidencial, f. 23532, rreshtat 3-8.

¹² CRSPD690, Mesazh Elektronik nga ZPS-ja drejtuar Trupit Gjykses lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 12 dhjetor 2024, konfidencial.

¹³ CRSPD690, Mesazh Elektronik nga ZPS-ja drejtuar Trupit Gjykses lidhur me Afatet për Dorëzimin e Parashtrimeve gjatë Pushimit të Gjykatës, 12 dhjetor 2024, konfidencial.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

9. Në bazë të rregullës 9(5)(a), nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio motu*, paneli mund të zgjasë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

IV. DISKUTIM

10. Trupi Gjykues vëren se, pas diskutimeve *inter partes*, palët dhe pjesëmarrësit pajtohen, me përjashtime të kufizuara, për pezullimin e afateve për parashtrimet dhe rishikimin e transkripteve të seancave private gjatë periudhës së pushimit dimëror të Gjykatës.¹⁴

11. Trupi Gjykues konstaton se palët kanë treguar arsye të vlefshme, në pajtim me rregullën 9(5)(a), për zgjatjen e afateve për parashtrimet dhe rishikimin e transkripteve të seancave private, duke pasur parasysh numrin e afateve me të cilat përballen palët dhe pjesëmarrësit, si dhe përkimin e tyre me periudhën e pushimit dimëror të Gjykatës. Zgjatja e afateve për parashtrimet dhe rishikimin e transkripteve të seancave private gjatë pushimit dimëror të Gjykatës lejon që palët dhe pjesëmarrësit të dorëzojnë parashtrime më të dobishme dhe të përgatiten në mënyrën më të efektshme për fazën e ardhshme të procesit.

12. Trupi Gjykues pajtohet se disa përjashtime nga zgjatja e afateve mund të jenë të arsyeshme. Duke pasur parasysh rëndësinë e dorëzimit në kohë të parashtrimeve për rishikimin e paraburgimit, në përputhje me nenin 41(10) dhe rregullën 57(2), këto parashtrime do të përjashtohen nga urdhri për zgjatjen e afateve. Përjashtimi vlen edhe për parashtrimet në lidhje me çështje urgjente, të cilat kërkojnë përgjigje dhe shqyrtim në kohë. Në këto parashtrime, palët dhe pjesëmarrësit duhet të paraqesin arsyet e urgjencës. Palët dhe pjesëmarrësit do t'u

¹⁴ Periudha e pushimit dimëror të Gjykatës zgjat nga e hëna, 23 dhjetor 2024, deri të premten, 10 janar 2025. KSCPR-2023, F00002, Kryetarja, Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2024, 25 shtator 2023.

përgjigjen këtyre parashtrimeve në përputhje me afatet e përcaktuara në rregullën 76, me përjashtim të rasteve kur miratohet kërkesa për përshpejtimin ose zgjatjen e afateve për parashtrime.

13. Për arsyet sa më lart, me përjashtim të (i) parashtrimeve lidhur me rishikimin e paraburgimit dhe (ii) rasteve kur për arsye urgjente kërkohet një përgjigje në kohë nga palët dhe pjesëmarrësit dhe pala parashtruese kërkon vendim mbi këtë bazë, Trupi Gjykses miraton zgjatjen e afateve për parashtrimet dhe rishikimin e transkripteve të seancave private që përkojnë me periudhën e pushimit dimëror të Gjykatës.

14. Afatet për parashtrimet, të cilat përkojnë me periudhën e pushimit dimëror të Gjykatës, përfshirë për përgjigjet dhe kundërpërgjigjet ndaj mocioneve sipas rregullës 77, do të fillojnë nga **e hëna, 13 janar 2025**, sipas afateve të përcaktuara në rregullat 9(2) dhe 76. Rishikimi i transkripteve të seancave private do të kryhet sipas afateve për të cilat palët dhe pjesëmarrësit kanë rënë dakord dhe që janë miratuar nga Trupi Gjykses.¹⁵

V. VENDIM

15. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **MIRATON** Kërkesën, pjesërisht; dhe
- b) **URDHËRON** që, me përjashtim të parashtrimeve lidhur me rishikimin e paraburgimit dhe çështje urgjente, afatet për parashtrimet dhe rishikimin e transkripteve të seancave private që përkojnë me periudhën e pushimit dimëror të Gjykatës, do të fillojnë nga **e hëna, 13 janar 2025**, sikurse

¹⁵ Transkripti i seancës, 7 nëntor 2023, f. 9444, rreshti 14, deri në f. 9446, rreshti 21.

përkthehet në paragrafin 14 më sipër.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 19 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.